



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:085777
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05503218

C.nr.703/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN me gjyqtarën Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore L.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), nga Prizreni, të cilën e përfaqeson i autorizuari V.C. nga Prizreni, kundër të paditurit Adnan Emin Halilaj, nga Prizreni, për kompenzimin e dëmit material, me datë 25.03.2024, morri këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Ndërpritet procedura në këtë çështje juridike për shkak të vdekjes të paditurit A.E.H. ish nga Prizreni.
- II.** Procedura do të vazhdohet pasi që të lajmërohen pasardhësit të paditurit.

A r s y e t i m

Paditësi pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër te paditurit, për kompenzimin e dëmit material.

Gjykata me shikim në fletëdergesë për dorëzimin personal konstaton sipas shënimit zyrtarë të dorëzuesve të gjykatës me datë 26.02.2024 se pala ka nderuar jetë sipas deklaratës të familjarëve të ndjerit.

Në bazë të nenit 277 të Ligjit për procedurës kontestimore (LPK) procesi gjyqësor ndërpritet paragraf 1. pika a) kur pala ndërgjyqëse vdes dhe procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e marrin përsipër procedurën, apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e pales kundërshtare, në nenin 280, paragraf 1. pika a), (LPK) të këtij ligji.

Nga përpara, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.703/20 datë 25.03.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh pas marrjes se te njëjtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë, nëpërmjet te kësaj gjykate.